REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:042574

Datë: 29.04.2022

Numri i dokumentit: 02970107

P.nr.28/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, **Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdijaj dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarve : 1.R., Sh., nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK) dhe veprës penale-Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 dhe 2.S.. Sh.. nga fsh..-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.308/2022, të datës 02.03.2022 (2022:0011721), duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 29.04.2022, mori këtë :

A K T GJ Y K I M

- PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm **PP-II.nr.308/2022, të datës 02.03.2022,** dhe gjykata e jepë këtë:

U R DH Ë R N D Ë SH K I M O R

1.- I akuzuari R.. Sh.. nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë ... i lindur me datë (data e lindjes) në Skenderaj, me vendbanim në fsh....-Komuna Skenderaj, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i punësuar në subjektin afarist "Ideali" Sh.P.K. i gjendjes së mesme ekonomike.

2.- E akuzuara S., Sh., mbiemri i vajzërisë ... nga babai .. dhe nëna ..., e lindur me datë (data e lidjes) në ..., me vendbanim në fsh....-Komuna Skenderaj, me numër personal 1005412613,

2022:042575

shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, e martuar, e papunë, e gjendjes së dobët ekonomike.

I.- I akuzuari Redon Shaqiri :

- Ë SH T Ë F A J T O R -

- SEPSE : Me datë 13.01.2022 rreth orës 19:30, në fshatin ....-Komuna Skenderaj, pikërisht në shtëpinë e F., Sh., i pandehuri me dashje tenton të sulmojë personin tjetër dhe atë të dëmtuarin F., Sh., ashtu që, fillimisht e thyen derën e hyrjes së shtëpisë së të dëmtuarit e pastaj hynë brenda dhe i vërsulet të dëmtuarit ., që ta sulmoj duke i thënë me fjalët "ku je se pa ta q.. nanen se la" dhe ka dashtë ta godas të njëjtin mirëpo, ka ndërhyrë e dëmtuara bashkëshortja e F., A., e cila në ato çaste ishte aty.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Sulmi nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

II.- Të akuzuarit Redon Shaqiri dhe Samije Shaqiri:

- J A N Ë F A J T O R Ë -

- SEPSE : Me datë, vend dhe kohë si në pikën e parë të kësaj aktakuze të pandehurit me dashje i shkaktojnë lëndime të lehta trupore tani të dëmtuarës A., U., ashtu që, pasi që fillimisht i pandehuri R., kishte tentuar ta sulmojë të dëmtuarin ... më pas, i njëjti ka filluar që ta godas të dëmtuarën A., U., me grushte në fytyrë ku në ato momente kishte arritur edhe nëna e të pandehurit .. ku edhe kjo e kishte goditur në pjesën e kokës me çka të njëjtës i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje të indeve të regjionit ballor të kokës dhe gërvishtje në shuplaka të duarve të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale-Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet : 4, 38, 43, 69, 70 dhe 76 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 453 par.1, nenit 463 par.1 dhe 2, nenit 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, **të akuzuarit të parë** :

- I A C A K T O N -

2022:042575

I.- Për veprën penale-Sulmi nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dënim me gjobë në shumë prej njëqind e pesëdhjetë (150.00) euro, të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Për veprën penale-Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dënim me gjobë në shumë prej treqind pesëdhjetë (350.00) euro, të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Në bazë të nenit 76, par.1 dhe par.2, nënpar.2.4 të KPRK-së të akuzuarin e parë :

- E GJ Y K O N –

I.- Me dënim unik me gjobë në shumën prej pesëqind (500.00) euro, të cilin dënim unik me gjobë është i obliguar që ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Të akuzuarës së dytë, Gjykata i shqipton **Dënim me gjobë** në shumën prej **dyqind e pesëdhjetë (250.00) euro**, të cilin dënim me gjobë është e obliguar që ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse të akuzuarit dënimet e shqiptuara me gjobë nuk i paguajnë në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimet e shqiptuara me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do t'ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të iu llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohen të akuzuarit që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore në mënyrë solidare shumën prej njëzetë (20.00) Euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20.00 € (njëzetë euro) secili veç e veç si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro) secili veç e veç, që të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Palët e dëmtuara ... dhe .., të dy me vendbanim në fsh....-Komuna Skenderaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregulltë civil.

A r s y e t i m

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 03.03.2022 ka parashtruar aktakuzën PP-II.nr.308/2022 të datës 02.03.2022, kundër të akuzuarve 1.R., Sh., nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale-Lëndimi i lehtë trupor nga

2022:042575

neni 185 par.1, nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe 2.S., Sh., nga ...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe në bazë të nenit 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarve t'iu shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

- Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhërit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPPK-së.

- Gjykata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë si : Raporti i oficerit policor-V., M., Nr.2022-BF-00025 i datës 13.01.2022, Procesverbalet mbi marrjen në pyetje të dëmtuarëve-... dhe ... Nr.2022-BF-00025 të datës 13.01.2022 lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbalet mbi marrjen në pyetje të akuzuarve-R., Sh., dhe S., Sh., Nr.2022-BF-00025 të datës 13.01.2022 dhe 11.02.2022 lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit-.. Nr.2022-BF-00025 i datës 13.01.2022 lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Akt ekspertimi mjeko-ligjor i datës 18.02.2022 në emër të dëmtuarës ... punuar nga ekperti mjeko-ligjor, Dr..., si dhe nga vështrimi në fotodokumentacion-fotoalbumi me gjithsejë gjashtë (6) faqe dhe të gjitha shkresat e tjera të lëndës, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit të parë përmbushen të gjitha elementet e veprës penale në tentativë-**Sulmi nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së**, ngase i njëjti me datë ... rreth orës 19:30, në fshatin ...-Komuna Skenderaj, pikërisht në shtëpinë e ... i pandehuri me dashje tenton të sulmojë personin tjetër dhe atë të dëmtuarin ... ashtu që, fillimisht e thyen derën e hyrjes së shtëpisë së të dëmtuarit e pastaj hynë brenda dhe i vërsulet të dëmtuarit ... që ta sulmoj duke i thënë me fjalët "ku je se pa ta q.. nanen se la" dhe ka dashtë ta godas të njëjtin mirëpo, ka ndërhyrë e dëmtuara bashkëshortja e ... e cila në ato çaste ishte aty.
- Poashtu, nga këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit të parë dhe të akuzuarës së dytë, përmbushen të gjitha elementet e veprës penale në bashkëkryerje-**Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së,** ngase të njëjtit me datë, vend dhe kohë si në pikën e parë të kësaj aktakuze të pandehurit me dashje i shkaktojnë lëndime të lehta trupore tani të dëmtuarës ....ashtu që, pasi që fillimisht i pandehuri ... kishte tentuar ta sulmojë të dëmtuarin ... më pas, i njëjti ka filluar që ta godas të dëmtuarën ... me grushte në fytyrë ku në ato momente kishte arritur edhe nëna e të pandehurit ... ku edhe kjo e kishte goditur në pjesën e kokës me çka të njëjtës i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje të indeve të regjionit ballor të

2022:042574

kokës dhe gërvishtje në shuplaka të duarve të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penalo-juridik janë përgjegjës dhe iu shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata mori parasysh dhe vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarin e parë rrethanë lehtësuese gjeti, rrethanat e tij personale se i njëjti është i moshës së re-njëzetë e dy (22) vjeçar, ndërsa rrethanë rënduese në rastin konkret gjeti shkallën e lartë të dashjes të të akuzuarit si dhe shkallën e përgjegjësië penale të tij, ashtu që nga veprimet e këtij të akuzuari, të dëmtuarës i është cenuar integriteti trupor përkatësisht, të njëjtës i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore.

Sa i përket të akuzuarës së dytë, gjykata si rrethanë lehtësuese gjeti, rrethanat e saj personale se i njëjta është e martuar, ka të kryer shkollën fillore, ndërsa rrethanë rënduese në rastin konkret gjeti shkallën e lartë të dashjes të të akuzuarës si dhe shkallën e përgjegjësië penale të saj, ashtu që nga veprimet e të njëjtës, të dëmtuarës i është cenuar integriteti trupor përkatësisht, i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore. Andaj, duke u bazuar në rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cekura si më lartë gjykata të akuzuarve iu shqiptoj dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke pritur me të drejtë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 dhe nenit 495 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.28/2022 me datë 29.04.2022.

Procesmbajtësja,
Florije Gucati

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdijaj

2022:042575

- KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtmi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.

2022:042575